

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 651 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

VENDIM Nr. 90, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të *projektit "Zgjerimi i terminaleve të pasagjerëve, Porti Detar i Vlorës"* -subjekti "Porti Detar i Vlorës" sh.a., realizuar nga ASHA,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të *projektit "Zgjerimi i terminaleve të pasagjerëve, Porti Detar i Vlorës"* -subjekti "Porti Detar i Vlorës" sh.a., realizuar nga ASHA.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO